



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno:	25.11.2024
Njësi Jedrinja	01-300/01-58606
Shtojca Dodatak	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 si dhe pikes 4 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Tetra Tech ARD, Inc. dhe Komunës së Lipjanit Nr.1-016/01-52730 të datës 29.09.2022, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN KËSHILLIT PUBLIK PRIVAT NË KOMUNËN E LIPJANIT

Neni 1 Themelimi

Me këtë Vendim themelohet Këshilli Publik Privat në Komunën e Lipjanit, (në vazhdim të tekstit KPP)

Neni 2 Qëllimi

Themelimi i KPP-së bëhet me qëllim të krijimit të një trupi konsultativ dhe këshillëdhënës për të ndarë përvojat dhe për të lehtësuar konsultimet ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Sektorit Privat. Qëllimi kryesor i këtij Këshilli është avansimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit të nivelit lokal me sektorin privat biznesor për të mbajtur dhe avansuar tutje ambientin e mirë të të bërit biznes si dhe për të nxjerr investimet në Komunën e Lipjanit.

Neni 3 Objektivat dhe Roli i KPP

1. Këshilli Publik-Privat ka për qëllim kryerjen e këtyre funksioneve specifike:

1.1 Këshillimi dhe Ndihmesa për Kornizën Ligjore: Këshilli do të veprojë si forum për komunikim të drejtpërdrejtë dhe produktiv ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesve të sektorit privat, me fokus në përmirësimin e kornizës ligjore për bizneset përkitazi me aktet e ndryshme të komunës me qëllim të sigurimit të një mjedisi të favorshëm për bizneset në Komunën e Lipjanit.

1.2 Përfshirja në njoftimin e përvitshëm për listën e pronave komunale për marrje në shfrytëzim për çdo vit paraprak sipas legjislacionit në fuqi: Këshilli do të njoftohet për procesin e listës së pronave komunale që do të jepen për shfrytëzim, në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës si dhe prioritetet e zhvillimit lokal për çdo vit kalendarik.

- 1.3 Dialog dhe Konsultim për Dokumentet dhe Planet Strategjike Komunale:**
Këshilli do të konsultohet dhe dialogojë lidhur me rregulloret komunale që ndikojnë në zhvillimin e biznesit, përfshirë buxhetin komunal, planin e prokurimit, dokumentet strategjike komunale dhe çështje të tjera të propozuara nga Kryetari ose përfaqësues të sektorit privat.

Neni 4 Përbërja e Këshillit Publik-Privat

1. Këshilli do të përbëhet nga:

- 1.1 **Anëtarë nga Komuna:** Drejtorët përkatës të të gjitha Drejtorateve të përfshira në fushat me interes për sektorin privat.
- 1.2 **Përfaqësues të Sektorit Privat:** Përfaqësues të kompanive të mëdha që veprojnë në Komunën e Lipjanit, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në përmirësimin e klimës së biznesit dhe zhvillimin ekonomik të komunës.
- 1.3 Përfaqësues të shoqatave të bizneseve që operojnë në komunë.
- 1.4 KPP do të veprojë në baza vullnetare pa ndonjë kompensim të caktuar.

Neni 5 Organizimi i Takimeve

1. Këshilli Publik-Privat do të mbledhet së paku tre herë në vit me mundësi për takime shtesë kur është e nevojshme.
2. Takimet do të drejtohen nga Kryetari/Nënkryetari i Komunës së Lipjanit apo Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, dhe sipas nevojës, do të ftohen edhe drejtorë të tjerë të drejtorateve komunale që lidhen me temat e diskutimit.
3. Këshilli ka të drejtë të propozojë çështje për diskutim dhe të rekomandojë veprime që janë të rëndësishme për sektorin privat dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Neni 6 Sekretariati dhe mbështetja administrative

1. Drejtorati përgjegjës për Ekonomi dhe Zhvillim ofron mbështetje profesionale, administrative dhe teknike për nevojat e takimeve të KPP-së.
2. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim është përgjegjës për nxjerrjen e udhëzuesit/rregullave të brendshme për funksionimin e KPP-së.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe ju dërgohet të gjithë drejtorëve të drejtorateve komunale në Komunën e Lipjanit dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullore MF- nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Doracakut të Procedurave të MFK-së pika 4 – Procedurat e MFK-së Nr.4 – Menaxhimi i Rrezikut si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR CAKTIMIN E KOORDINATORES PËR IDENTIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN E RREZIKUT PËR VITIN 2025 SIPAS PROCEDURAVE TË MFK-SË

Neni 1

Me këtë Vendim, Shehadije Ibrahim, zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa **CAKTOHET**, Koordinatore për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut për vitin 2025 sipas procedurave të MFK-së.

Neni 2

Nëpunësja civile e caktuar në nenin 1 të këtij Vendimi, do ti kryej punët dhe detyrat si detyrë shtesë krahas detyrave të punës, konform Rregullores MF- nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe Doracakut të Procedurave të MFK-së.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe dhe Nëpunësja civile e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

1Nr. 020/04-56219
Lipjan, më 08.11.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e rinisë dhe kulturës në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-57033 të datës 13.11.2024, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ganimete Osmani, nga OJQ-të, anëtare
5. Fatbardha Drnogllava, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtare dhe
6. Besmir Retkoceri, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar rezerv

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e rinisë dhe kulturës në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar konform thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-57033 të datës 13.11.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-58592
Lipjan, më 22.11.2024

KRYETARI KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që drejtojnë qendrat mësimore që mbështesin nxënësit romë, ashkali dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë që kontribuojnë në arritjen arsimore në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.4-453/01-53287 të datës 24.10.2024, në përbërje si vijon:

1. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim, Kryesues
2. Mexhide Gashi, Drejtorati për Arsim, anëtare
3. Shehide Sopa-Ibrahimi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Bekim Krasniqi, nga OJQ-të, anëtar
5. Shaip Fazliu, në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtare rezerv

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që drejtojnë qendrat mësimore që mbështesin nxënësit romë, ashkali dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë që kontribuojnë në arritjen arsimore në Komunën e Lipjanit, konform Thirrjes publike për aplikim Nr.4-453/01-53287 të datës 24.10.2024, të shpallur nga Drejtorati për Arsim, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-57081
Lipjan, më 14.11.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (Klubeve sportive) në zbulimin dhe promovimin e talenteve të rinj të sportit në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-57004 të datës 13.11.2024, në përbërje si vijon:

1. Agim Bylygbashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Valmira Marevci, nga OJQ-të, anëtare
5. Ganimete Osmani, në cilësinë e ekspertes së jashtëm, anëtare dhe
6. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar rezerv

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (Klubeve sportive) në zbulimin dhe promovimin e talenteve të rinj të sportit në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-57004 të datës 13.11.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-59223

Lipjan, më 29.11.2024

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – RREGULLOREN PËR TRANSPARENCË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Rregullorja për Transparencë e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft - Rregullore për Transparencë e Komunës së Lipjanit, mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft e Rregullores ose në email adresën bukurie.zejnullahu@rks-gov.net, më së largu me datë 12.12.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 016/01-59121
Lipjan, më 27.11.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službeni List Republike Kosovo, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipjan Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu opštine, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipjan, Br. 15-353-35739 dt.30.06.2023, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT - UREDBU O TRANSPARETNOSTI OPŠTINE LIPLJAN

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objavit će se na Websajtu Opštine:

Projekt -. Uredbu o Transparentnosti Opštine Lipljan

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt – Uredbu o Transparentnosti Opštine Lipljan moraju biti poslani radnoj Komisiji za izradu projekta na email adresu: bukurie.zejnullahu@rks-kosovo.gov.kg najkasnije do 12.12.2024.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajtu Opštine.

1Br. 016/01-59121
Lipljan, 27.11.2024

PREDSIEDNIK OPŠTINE
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,560.00€**, (shtatë mijë e pesëqindë e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-54468 e datës 31.10.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 27 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin tetor të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast $27 \times 280 = 7,560.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhironlogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-54468
Lipjan, më 01.11.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 të Rregullores MD Nr.13/2024 për organizimin dhe funksionimin e panelit për strehim rezidencial si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR THEMELIMIN E PANELIT PËR STREHIM REZIDENCIAL NË KOMUNËN E
LIPJANIT

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim , **THEMELOHET** Paneli për Strehim Rezidencial në Komunën e Lipjanit në përbërje si vijon:

1. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesues
2. Hyrije Qerkini, Qendra për Punë Sociale, anëtare
3. Driton Ibrahim, Shtëpia e komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore – ngecje në zhvillim mendor, anëtar

Neni 2
Detyrat ,përgjegjësitë dhe mandati i panelit për strehim rezidencial

1.Paneli për Strehim Rezidencial ka këto përgjegjësi:

- 1.1. shqyrtimin e kërkesave për dhënie e pëlqimit për vendosjen e personave në nevojë dhe fëmijëve në strehim rezidencial sipas kërkesës së Qendrës për Punë Sociale
- 1.2. vlerësimin e respektimit të procedurave ligjore dhe profesionale nga ana e Qendrës për Punë Sociale;
- 1.3. Paneli mund të kërkoj dokumentacion shtesë sipas nevojës;
- 1.4. bashkëpunon me mekanizmat e nivelit qendror për strehim rezidencial dhe lokal në një Komunë tjetër.
- 1.5. Paneli pas konstatimit se janë shterur të gjitha mundësitë për format tjera alternative, nëse vlerëson se është në interesin më të mirë të fëmijës apo përfituesit tjetër jep pëlqim për Strehim Rezidencial.

- 1.6. Paneli kryen edhe punë dhe detyra tjera që kërkohen konform dispozitave të Rregullores MD Nr.13/2024 për organizimin dhe funksionimin e panelit për strehim rezidencial.
2. Mandati i Panelit për strehim rezidencial është (3) vite.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Panelit.

1Nr. 360/09-58380
Lipjan, më 22.11.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 duke u bazuar në Aneks Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Islamic Relief Worldwide –Zyra në Kosovë (IRW) dhe Komunës së Lipjanit me Nr.01-320/01-58024 e datës 20.11.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

1. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **2.000.00 €** (dy mijë euro), për të vepruar konform dispozitave të Aneks Marrëveshjes e lidhur ndërmjet Islamic Relief Worldwide –Zyra në Kosovë (IRW) dhe Komunës së Lipjanit me Nr.01-320/01-58024 e datës 20.11.2024.

2.Ndarja e mjeteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Aneks Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Islamic Relief Worldwide –Zyra në Kosovë (IRW) dhe Komunës së Lipjanit me Nr.01-320/01-58024 e datës 20.11.2024, qëllimi i së cilës ishte amandamentimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Worldwide –Zyra në Kosovë (IRW) dhe Komunës së Lipjanit të nënshkruar me datë 17.08.2023 me numër të protokollit 01-413/01-44206, përkitazi me bashkimin e mjeteve /fondeve për projektin” Mbështetja e bujqësisë për familjet e varfra në Kosovë”.

Neni 2

Islamic Relief Worldwide –Zyra në Kosovë (IRW) do ti raportoj me shkrim Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, lidhur me veprimet e ndërmarra konform dispozitave të kësaj Aneks -Marrëveshje ku përfshihet Raporti financiar lidhur me mjetet e shpenzuara dhe arsyetimi i tyre me fatura dhe dokumentacion tjetër përkatës.

Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2024 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare të IRW me numër 170800008014285 në NLB.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

INr. 4006/1-58145
Lipjan, më 21.11.2024

KRYETARI I KOMUNES
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 17 pika h) dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Ligjit nr.04./L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr.03/L-068 për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

I. **NDALOHET**, zbatimi i Doracakut për mësimdhënës “Edukimi seksual dhe shëndeti riprodhues i shëndoshë dhe i sigurtë” i nxjerrur nga MASHT-i në tri nivelet e arsimit parauniversitar në Komunën e Lipjanit :

- Arsimi i nivelit fillor(1-5)
- Arsimi i mesëm i ulët (6-9) dhe
- Arsimi i mesëm i lartë (10-12).

II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, obligohen Drejtoritë e shkollave në tri nivelet e arsimit parauniversitar respektivisht mësimdhënësit e këtyre niveleve që zhvillimi i mësimdhënies për nxënës të mos trajtojë përmbajtje që rrjedhin nga Doracaku i cekur më lartë.

III. Sipas pikës I dhe II të këtij Vendimi, zhvillimi i mësimdhënies do të bëhet vetëm sipas teksteve shkollore në përputhje me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ky Vendim merret me qëllim të ruajtjes së mirëqenies së fëmijëve bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Konventat për mbrojtjen e fëmijëve.

Vendimi i dorëzohet:

DKA,

Drejtorive të Shkollave dhe

Arhivës

1Nr. 610/01-57376

Lipjan, më 15.11.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

